



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:013425
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05700075

AA.nr.593/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, F.H, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqësojnë, Esat Gutaj dhe Mbaresë Gutaj, që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson, Avdyl Bekteshi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional dhe palës me interes juridik, Komuna e Gjakovës, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.148/22, të datës;20.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, F.H, Komuna e Gjakovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.148/22, i datës;20.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjën A.nr.148/22, të datës;20.07.2023, është vendosur, “I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia paditësit F.H, Komuna e Gjakovës, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK) në Prishtinë, nr. A.nr.1056/2021 të datës 31.12.2021. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i paditësi, për shkak shkeljes esenciale të dispozitave procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi A.nr.148/22, i datës;20.07.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të priset dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe vendosje, ose të vendos në favor të pretendimeve ankimore duke e aprovuar padinë në tërësi si të bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:24.01.2022, kundër vendimit të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me seli në Prishtinë, A.nr.1056/2021, të datës:31.12.2021, sepse konsideron se vendimi i kundërshtuar me padi është i pa drejt dhe jo i ligjshëm, me propozim që Gjykata të vendos në mënyrë meritore dhe të aprovojë padinë si të bazuar dhe paditësi të kthehet në vendin e punës.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër të paditurit, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Për të vlerësuar këtë, gjykata fillimisht iu referua Rregullores Nr.01/2011, për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Pezullimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil konkretisht nenit 3 i cili përcakton se: “Puna provuese nënkupton periudhën e punës se nëpunësit civil me kohëzgjatje të caktuar pas nënshkrimit të akt emërimit, gjatë së civil vlerësohet nëpunësi civil për realizimin e detyrave të punës”. Ndërsa neni 8 i kësaj rregullore përcakton se:” Takimi për periudhën provuese organizohet me qëllim që udhëheqësi i drejtpërdrejtë dhe nëpunësi civil bashkëbisedojnë për përmbushjen e detyrave të punës gjatë periudhës provuese”. Në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes civile në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë, me datën 03.01.2019 paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për shkak mos zbatimit të detyrave të punës, vërejtjeve të paraqitura të qytetarëve, mosrespektimin e udhëzimeve të udhëheqëses së gjendjes civile dhe mos respektimin e orarit të punës, ku i njëjti me veprimet e tij si zyrtar i gjendjes civile është treguar i papërgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës nuk ju ka përmbajtur kodit të mirësjelljes. Në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se paditësi ka shfaqur sjellje jo korrekte dhe ofenduese ndaj qytetarëve, me ç’rast të njëjtit kanë kërkuar marrjen e masave të menjëhershme disiplinore ndaj tij përmes ankesave të parashtruara. Po ashtu, vërtetohet se paditësi me sjelljet e tij ndaj qytetarëve dhe mos përmbushjen e detyrave të punës për më tepër nuk ju ka përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe pas ankesave të drejtuar kundër paditësit nga udhëheqësja e zyrës të Sektorit të Gjendjes Civile edhe pas dërgimit të emailave të 12.02.2019 dhe 27.12.2018 nga personi zyrtar për takimin i njëjti në mënyrë të vazhdueshme nuk i ka përfillur urdhrat nga Zyrtarja mbikëqyrëse duke mos regjistruar në sistemin të pagesave certifikatat e lindjes për qytetarët dhe ky veprim bien në kundërshtim me procedurat e punës dhe ka shkelur Kodin e Etikës për Shërbyesit Civil. Kodi i Mirësjelljes për Nëpunësit Civilë Nr.01/2006, konkretisht nenit 10 par. 1 dhe 2, përcakton se: “10.1. Nëpunësit civilë nuk bënë ta pengojnë politikën e veprimit të autoritetit udhëheqës. Nëpunësit civilë duhet të përfillin konceptin e disiplinës në mënyrë që sjellja e tyre të jetë në përputhje të plotë me rregullat e sjelljes së mirëfilltë ndaj udhëheqësve të tyre. 10.2. Nëpunësit civilë duhet t’i ushtrojnë detyrat e tyre bazuar në planin dhe drejtimet e përcaktuara nga autoriteti udhëheqës”. Nga kjo gjykata konstaton se vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës dhe rrjedhimisht edhe aktvendimi kontestues i të paditurës KPMSHCK, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Paditësi*

nuk kishte ofruar prova me të cilat do të mbështeste pretendimet e dhëna në padi, ndërsa nga provat e administruara, nuk vërtetuar gjendje faktike tjetër nga ajo e vërtetuar nga e paditura. Andaj, nga kjo gjendje e vërtetuar del se vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe mbi këto arsye padinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të tij.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë aplikim të gabuar dispozitave procedurale, sipas vlerësimit të kolegjit ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditësi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet e dispozitave procedurale, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit të vendimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar ë pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se paditësi në ankesë edhe kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kjo për faktin se bazuar në shkresat e lëndës, vërtetohet se Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes civile në cilësi të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë në Komunën e Gjakovës, me datën 03.01.2019 paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, për shkak mos zbatimit të detyrave të punës, ankesave me shkrim të paraqitura nga qytetarët, të datës;15.01.2019, të datës;03.01.2019, dhe të datës;31.12.2019, mosrespektimin e udhëzimeve të udhëheqëses se gjendjes civile dhe mos respektimin e orarit të punës, ku i njëjti me veprimet e tij si zyrtar i gjendjes civile është treguar i papërgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës nuk ju ka përmbajtur kodit të mirësjelljes. Në bazë të shkresave të lëndës, po ashtu, vërtetohet se paditësi me sjelljet e tij ndaj qytetarëve dhe mos përmbushjen e detyrave të punës, nuk iu ka përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe pas ankesave të drejtuar kundër paditësit nga udhëheqësja e zyrës te Sektorit të Gjendjes Civile edhe pas dërgimit të emailave të dt.12.02.2019 dhe të dt.27.12.2018, nga personi zyrtar për takimin i njëjti në mënyrë të vazhdueshme nuk i ka përfillur urdhrat nga Zyrtarja mbikëqyrëse, duke mos regjistruar në sistemin të pagesave certifikatat e lindjes për qytetarët dhe ky veprim bien në kundërshtim me procedurat e punës dhe ka shkelur Kodin e Etikës për Shërbyesit Civil, në këtë kuptim edhe kolegji i apelit si Gjykata e shkallës së parë vlerëson se vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës, dhe rrjedhimisht edhe aktvendimi kontestues i të paditurit, KPMSHCK, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që paditësi me asnjë provë nuk i ka vërtetuar

pretendimet e tij ankimore, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, respektivisht nenit 3 të Rregullores Nr.01/2011, për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil Nr.01/2006, lidhur me nenin 20 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.593/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti